



## PROFILI I KOMPANISË

“MOBIAK SA” u themelua në vitin 1977 dhe është kompania më e madhe në Greqi dhe një nga kompanitë me rritjen më të shpejtë në Ballkan, Evropë dhe Lindjen e Mesme në fushën e industrisë së pajisjeve zjarrfikëse.

Për më shumë se 40 vjet, aktivitetet e “MOBIAK” janë fokusuar në zhvillimin e 3 fushave kryesore:

a) Gaze b) Pajisje zjarrfikëse dhe c) Pajisje mjekësore – Kujdesi në shtëpi

Më specifikisht, “MOBIAK” operon në fushat e mëposhtme:

- **MOBIAK - Sektori i gazit:** Prodhimi dhe imbotilimi i gazeve mjekësore–industriale, si p.sh. oksigjen, dioksid karboni, azot, argon, Corgon, IG 541, IG 55, ajër i komprimuar, Banarg etj.
- **MOBIAK - Sektori i pajisjeve zjarrfikëse:** Montimi dhe tregtimi i fikësve të zjarrit, projektimi, ambalazhimi-imbotilimi, tregtimi dhe instalimi i sistemeve për fikjen e zjarrit, tregtimi i të gjitha pajisjeve zjarrfikëse, si dhe testimi dhe kontrolli i fikjes së zjarrit.
- **MOBIAK - Sektori i kujdesit:** Importimi dhe tregtimi i pajisjeve mjekësore dhe produkteve të kujdesit shtëpiak, riparimi i pajisjeve mjekësore dhe objekte laboratorike për gjumë



Për sa i përket **departamentit të zjarrfikësve**, “MOBIAK” ka zbatuar një program investimi të madh prej 5 000 000 € në qendrën e saj në Hania, Kretë, i cili përfundoi në vitin 2006 dhe përfshiu instalimin e linjës së montimit tërësisht robotik për fikësit e zjarrit dhe ndërtimin e një objekti të ri 2500 m<sup>2</sup> për zyra të reja dhe zgjerimin e magazinës për lëndët e para dhe produktet gati për përdorim (800 m<sup>2</sup>).

Kapaciteti i linjës së re të prodhimit të fikësve të zjarrit është mbi **200 njësi/orë**. Sensori me ndjeshmëri të lartë i heliumit dikton rrjedhje të mundshme të gazit djegës për çdo fikës zjarri të prodhuar ose të ritestuar. “MOBIAK” tashmë tregton dhe prodhon mbi 1000 produkte të ndryshme.



Gama bazë e produkteve zjarrfikëse përbëhet nga:

- Fikës zjarri portativë dhe me rrota, me pluhur, shkumë, Co2, ujë, kimikat i lëngshëm, agjent pastrimi, të certifikuara nga agjenci të njohura ndërkombëtarisht si: BSI (MB), NF (Francë), Apragaz (Belgjikë), MPA Dresden (Gjermani), KIWA (Holandë), UL (SHBA), RINA (Itali), EBETAM (Greqi)
- Pjesë këmbimi dhe aksesore për të gjitha llojet e fikësve të zjarrit
- Materiale zjarrfikëse (pluhur i thatë, shkumë, kimikat i lëngshëm, HFC-227 ea, FK -5-1-12) të llojeve të ndryshme
- Fole bashkuese dhe bobina në disa dimensione dhe lloje modelesh, me certifikim EN nga LPCB (MB) dhe KIWA (Holandë)
- Panele zjarri dhe aksesore me certifikim EN dhe UL.
- Valvula dhe tuba të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme, me certifikim UL / FM dhe EN
- Sprinkler kundër zjarrit në madhësi dhe lloje të ndryshme, me certifikim UL
- Batanije kundër zjarrit në madhësi dhe lloje të ndryshme, me certifikim EN dhe BSI
- Pjesë dhe dyer metalike rezistente ndaj zjarrit, me certifikim EN
- Pajisje zjarrfikëse (uniforma, respiratorë, maska etj.)
- Sisteme të përhershme për fikjen e zjarrit (HFC-227 ea, FK -5-1-12, IG, CO 2, kimikat i lëngshëm, pluhur, avuj uji, prodhues aerosoli)
- Skuadra zjarrfikëse me certifikim UL / FM
- Pajisje për qendrat e rikuperimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve zjarrfikëse dhe sistemeve për fikjen e zjarrit




Janë bërë arritje të rëndësishme në marrjen e certifikimeve të tjera tejet kërkuese dhe të nevojshme për modele të ndryshme fikësish zjarri, si p.sh. SRPS (Serbi), NCP (Holandë), TSE (Turqi) dhe BENOR (Belgjikë). Zhvillimi dhe rritja e vazhdueshme e "MOBIAK" ndërthuret me përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve të saj.



Gjithashtu, kompania është e certifikuar nga Hellenic Register of Shipping, RINA, Bureau Veritas, ABS dhe kompania anijendërtuese ruse për inspektimin e pajisjeve zjarrfikëse, respiratorëve dhe sistemeve të sigurisë në anije. Me certifikimet e mësipërme, "MOBIAK" ka krijuar bashkëpunim me kompanitë e transportit detar për inspektimin vjetor të flotave të tyre.

Duke marrë pjesë në mënyrë aktive në fushat thelbësore të prodhimit, MOBIAK ka arritur jo vetëm të ketë një rrjet aktiv filialesh në Greqi, i cili tejkalon 800 shitës me shumicë, por edhe të eksportojë në mbarë botën me njërrjet ndërkombëtar shitjesh në më shumë se 70 shtete.



<p><b>EUROPE</b></p> <p>ALBANIA AUSTRIA BELGIUM BOSNIA BULGARIA CROATIA CYPRUS CZECH ESTONIA</p> <p>FINLAND FRANCE FYROM GEORGIA GERMANY HUNGARY ICELAND IRELAND ITALY</p> <p>KOSOVO LATVIA LITHUANIA LUXEMBURG MALTA MONACO MONTENEGRO NETHERLANDS NORWAY</p> <p>PORTUGAL ROMANIA RUSSIA SERBIA SLOVAKIA SLOVENIA SPAIN SWEDEN SWITZERLAND</p> <p>TURKEY UKRAINE UNITED KINGDOM</p>	<p><b>AFRICA</b></p> <p>ALGERIA BURKINA FASO CAMEROON CÔTE D'IVOIRE EGYPT ETHIOPIA ZAMBIA GUINEA LIBYA</p> <p>SAINT MAURITIOUS MOROCCO NIGERIA UGANDA SENEGAL SUDAN TUNISIA</p>	<p><b>ASIA</b></p> <p>BANGLADESH CHINA VIETNAM INDIA IRAQ IRAN JAPAN PAKISTAN S. KOREA</p>	<p><b>MIDDLE EAST</b></p> <p>BAHRAIN KUWAIT LEBANON QATAR SAUDI ARABIA SULTANATE OF OMAN UNITED ARAB EMIRATES (UAE)</p>
<p><b>AMERICA</b></p> <p>USA PANAMA</p>	<p><b>OCEANIA</b></p> <p>FRENCH POLYNESIA (TAHITI)</p>		



"MOBIACARE", sektori mjekësor i "MOBIAK", është një nga markat më të mëdha të shitjeve me shumicë për kujdesin shtëpiak që operon në Evropën Jugore.

Me fushë specializimi që përfshin pajisjet e terapisë me oksigjen, pajisjet për diagnostikimin/trajtimin e çrregullimeve të gjumit, pajisjet për çrregullimet respiratore, ventilatorët (invazivë, joinvazivë), artikujt ortopedikë, karriget me rrota, krevatet për kujdesin në shtëpi, pajisje ndihmëse të lëvizjes dhe produkte për kujdesin në shtëpi dhe spital.

"MOBIAK" ka përvojën, njohuritë dhe infrastrukturën e duhur, si dhe një rrjet mbarëbotëror për të mbështetur produktet dhe partnerët tanë. Ai ka edhe një avantazh të madh të objekteve: Athinë (4000 m<sup>2</sup>), Selanik (5000 m<sup>2</sup>) dhe Kretë (Hania 3500 m<sup>2</sup> - Iraklion 700 m<sup>2</sup>).

Me **tre pika shërbimi** që mbulojnë të gjithë Greqinë dhe me teknikë të specializuar, gjithashtu të autorizuar nga qendrat evropiane të certifikimit në Greqi, ne kemi krijuar mbi 20 laboratorë gjumi në Greqi dhe jashtë shtetit, kështu që mund të vërtetojmë besueshmërinë dhe përvojën tonë në këtë fushë.

Të gjitha të mësipërmet, si dhe cilësia e produkteve dhe shërbimeve, dorëzimet e shpejta, mbështetja teknike dhe çmimet konkurruese e kanë bërë "MOBIAK" një nga markat më të njohura.



**Sektori "MOBIAK Gas"** po punon me disa nga kompanitë më të mëdha në botë. "MOBIAK" furnizon lëndët e para në formë të lëngshme (oksigen, dioksid karboni, azot, argon), i ruan në depozita kriogjenike dhe i imbotilon në presion të lartë. Kjo ofron mundësinë e furnizimit me oksigjen të lëngshëm me një autocisternë private në të gjitha spitalet publike dhe klinikat private në Kretë.

Në vitin 2006 u bë gjithashtu një investim i rëndësishëm prej € 1 000 000 në sektorin e gazit. U instalua një linjë e re imbotilimi dhe ndërtesat e vjetra u rinovuan tërësisht (1000 m<sup>2</sup>).

Katër parimet e kompanisë: Cilësia, llojshmëria, çmimet konkurruese dhe dorëzimi i menjëhershëm kanë kontribuar më së shumti në progresin e vullshëm dhe rruga e suksesshme vazhdon me zgjerimin e aktiviteteve.



Në vitin 2018, "MOBIAK" bleu një ngastër të re prej 25 000 m<sup>2</sup>, duke zgjeruar fabrikën, ku do të ndërtohen ndërtesa të reja për të akomoduar një linjë tjetër për montimin robotik të fikësve të zjarrit, si dhe ambalazhimin automatik të produkteve dhe stivimin e porosive. Tani ekziston mundësia e paketimit/stivimit të personalizuar sipas sasive. Gjithashtu, po ndërtohet një ndërtesë e re 2000 m<sup>2</sup>, me funksionin e qendrës së shpërndarjes - një zonë për magazinimin e produkteve. Gjithashtu, në të njëjtën ngastër do të krijohet një qendër trajnimi - qendër eventesh - sallë konferencash, duke e kthyer në një **seli moderne** për kompaninë. Së fundi, investimi përlloritet të jetë € 7 000 000, plus koston e blerjes së truallit.



Me burime njerëzore prej më shumë se 140 personash dhe me makineri moderne, MOBIAK mund të garantojë produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë, dhe është njëkohësisht i certifikuar nga ISO 9001: 2015 nga agjencia e vlerësimit të cilësisë ABS, sipas ISO 14001: 2015 nga TUV Rheinland, OHSAS 18001: 2007 nga EBETAM dhe sipas ISO 13485: 2012 nga NOACTH greke.

Përkushtimi i kompanisë ndaj vizionit fillestar për cilësinë e përgjithshme të produkteve dhe shërbimeve të saj ka bërë që "MOBIAK" të fitojë vendin e parë në Greqi, si dhe të pozicionohet ndër kompanitë evropiane me rritjen më të shpejtë në këtë sektor.

Provë e kësaj është njohja nga organizatat ndërkombëtare të certifikimit që japin vlerësime dhe certifikime që shumë pak kompani në këtë industri i kanë.



Central facilities – Factory in Chania – Crete- Greece



Conference room



Warehouse in Crete



Automatic Production Line



Labeling Machine



Gas Bottling Unit



Warehouse in Athens - Greece



Warehouse in Thessaloniki - Greece



MOBIAK Balkans  
Branch (F.Y.R.O.M)



Warehouse in Heraklion - Crete